

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Emine Mustafa, kryetare, Valdete Daka dhe Rasim Rasimi, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale të të dënuarve F.K., për shkak të veprës penale vrasje nga neni 178 të KPK-së dhe lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par. 2 lidhur me par. 1 pika 1.4. të KPK-së si dhe të dënuarit B.K. dhe E.M. për shkak të veprës penale pjesëmarrje në rrahje nga neni 190 par. 1 të KPK-së, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësve të dënuarve F. dhe B.K., paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë – DKR, P.nr.60/2015 datë 9.8.2016 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës-DKR, PAKR.nr.527/2016 datë 24.10.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 27.2.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHEN si të pabazuara kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësve të dënuarve F. dhe B.K., paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë – DKR, P.nr.60/2015 datë 9.8.2016 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës-DKR, PAKR.nr.527/2016 datë 24.10.2016.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë – DKR, P.nr.60/2015 datë 9.8.2016, i dënuari F.K. është shpallur fajtor për shkak të veprës penale vrasje e kryer në tejkallim të mbrojtjes së nevojshme nga neni 178 lidhur me nenin 12 të KPK-së për të cilën vepër i është përcaktuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) vite dhe për veprën penale dhe lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 pika 1.4. të KPK-së për të cilën vepër penale i është përcaktuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 1 viti dhe për këto vepra është gjykuar me dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) vite e 6 muaj, në të cilin dënim i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim prej 12.3.2013 deri më 10.5.2013 si dhe koha e kaluar në arrest shtëpiak prej datës 10.5.2013 deri më 19.12.2014, ndërsa nga data 19.12.2014 të dënuarit i është caktuar paraburgimi i cili do të zgjasë deri sa aktgjykimi të merr formën e prerë, por jo më tepër se sa dënimi i i shqiptuar me aktgjykim. Të dënuarit B.K. dhe

E.M., secili veç e veç janë shpallur fajtor për veprën penale pjesëmarrja në rrahje nga neni 190 par.1 të KPK-së dhe secili veç e veç është gjykuar dhe atë: i dënuari B.K. me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 1 (një) viti ndërsa i dënuari E.M. me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i dënuari në afat prej 1 (një) viti, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit nuk kryen vepër tjetër penale. I dënuari F.K. është obliguar që të paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor prej 536,16 € ndërsa të dënuarit B.K. dhe E.M., secili shumën prej nga 100 €, të gjitha në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në procedurën ankimore Gjykata e Apelit të Kosovës, me aktgjykimin PAKR.nr.527/2016 datë 24.10.2016, ka aprovuar pjesërisht ankesën e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, është ndryshuar aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë vetëm sa i përket të dënuarit F.K. dhe atë përkitazi me cilësimin juridik dhe vendimin mbi dënimin, ashtu që gjykata e Apelit të Kosovës, ka gjetur se në veprimet e të dënuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale të vrasjes nga neni 178 të KPK-së për të cilën vepër e ka gjykuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 10 vitesh ndërsa ia ka marrë si të vërtetuar dënimin e gjykatës së shkallës së parë për veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 pika 1.4. të KPK-së, dënimin me burg në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, dhe për veprat penale të kryera ia ka shqiptuar dënimin unik me burg në kohëzgjatje prej 10 vjet e 6 muaj, në të cilin dënim ia ka llogaritur edhe kohën e kaluar në paraburgim nga data 12.3.2013 deri më 10.5.2013, koha e kaluar në arrest shtëpiak prej 10.5.2013 e deri më 19.12.2014 dhe paraburgimi prej datës 19.12.2014 e tutje. Me po të njëjtin aktgjykim ankesat e mbrojtësve të dënuarve F.K., B.K. dhe E.M. janë refuzuar si të pabaza ndërsa në pjesën tjetër aktgjykimi ka mbetur i pandryshuar.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë kanë paraqitur:

- mbrojtësi i të dënuarit F.K., av. B.E., për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 të KPK-së dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që aktgjykimet e kundërshtuara të ndryshohen dhe i dënuari të lirohet nga akuza apo të anulohen dhe çështja të kthehet në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë si dhe të ndërpritet ekzekutimi i dënimit deri në vendosje meritore;

- mbrojtësi i të dënuarit B.K., av. N.B., nga Vushtrria për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës penale të cilat shkelje kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor dhe për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 pika 1.12 të KPPK-së lidhur me nenin 370 pika 6 dhe 7 dhe nenin 7 të KPPK-së, me propozim që aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe çështja t'i kthehet në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

Prokurori i Shtetit, me shkresën KMLP.II.nr.41/2017 e datës 21.3.2017, ka propozuar që të refuzohen si të pabaza kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë të ushtruara nga mbrojtësit e të dënuarve.

Gjykata Supreme e Kosovës, shqyrtoi shkresat e çështjes në pajtim me dispozitën e nenit 435 par.1 dhe nenin 436 par.1 të KPPK-së, dhe pas vlerësimit të pretendimeve nga kërkesa, gjeti se:

Kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë janë të pabazuara.

Në kërkesën e tij mbrojtësi i të dënuarit F.K., av. B.E., pretendon se aktgjykimet e kundërshtuara janë të përfshira me shkelje të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 duke mos cekur cilat janë pikat ku pretendohen shkeljet, por duke theksuar se mungojnë arsyetimet lidhur me faktet vendimtare sidomos lidhur me deklaratën e dëshmitarit A.K., e cila ishte kundërthënëse dhe atë deklaratë e dhënë në polici më datë 12.3.2013 dhe e datës 1.2.2016 në rikonstrukcionin e vendit të ngjarjes. Mungon arsyetimi se pse i është falë besim një dëshmitari jokredibil si dhe për faktin se deklarata e dëshmitarit H.A. e datës 19.2.2014 është lexuar në shqyrtim gjyqësor edhe pse i njëjti ka qenë ftuar dhe nuk e ka arsyetuar mungesën e tij, ndërsa mbrojtja ka kërkuar që të lexohet vetëm deklarata e datës 1.2.2016 dhe për këtë në aktgjykimet mungon arsyetimi për arsyet e refuzimit të kësaj kërkesë.

Sa i përket shkeljes së ligjit penal, mbrojtësi pretendon se Gjykata e Apelit gabimisht dhe në dëm të të dënuarit ka bërë ricielësimin e veprës penale dhe e ka shpallur fajtor të dënuarin F.K. për veprën penale të vrasjes nga neni 178 të KPK edhe pse në shkresat e çështjes ka prova lidhur me tronditjen e fortë mendore të të dënuarit dhe se e njëjta gjykatë nuk jep fare arsyetim se cilat kanë qenë rrethanat lehtësuese dhe rënduese lidhur me këtë të dënuar kur ia ka shqiptuar dënimin me burgim prej 10 vjet e 6 muaj dhe se fare nuk është dhënë arsyetim lidhur me raportin mbi gjendjen e shëndetit mendor të të dënuarit F.K. edhe pse ky raport ka qenë provë e administruar në shqyrtimin gjyqësor.

Në kërkesën e tij mbrojtësi i të dënuarit B.K., av. N.B., pretendon se aktgjykimet janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 pika 1.12 të KPPK-së, për shkak se dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së parë është kontradiktor me vetveten dhe me arsyet e dhëna në të, nuk janë dhënë arsye për faktet vendimtare dhe se arsyetimi i tërësishëm i kushtohet vetëm veprën penale të vrasjes dhe fare nuk ka arsyetim lidhur me këtë vepër penale.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke vlerësuar pretendimet e mbrojtësit të dënuarit F.K., gjen se dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së parë, sa i përket veprës penale të vrasjes të kryer në tejkallim të mbrojtjes së nevojshme nga neni 178 lidhur me nenin 12 të KPK-së, ka qenë kontradiktorë dhe se i njëjti nuk i ka përmbajtur elementet e kësaj vepre penale dhe se kjo ka paraqitur shkelje procedurale, mirëpo me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë, kjo shkelje është tejkalluar me faktin se gjykata e shkallës së dytë ka aprovuar ankesën e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, duke ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë përkitazi me cilësimin juridik dhe vendimin mbi dënimin e duke gjetur se në veprimet e të dënuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale të vrasjes nga neni 178 të KPK-së, dhe për këtë ka dhënë arsye të mjaftuara ligjore të

cilat si të drejta i pranon edhe kjo Gjykatë. Dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së dytë është i qartë, i kuptueshëm dhe nuk ka kontradikta as me vetveten as me arsyet e dhëna lidhur me faktet vendimtare të cilat i kanë paraprirë vendosjes meritore.

Sa i përket pretendimeve se aktgjykimi bazohet vetëm në deklaratën e dëshmitarit A.K., dhe se deklaratat e tij janë kontradiktore, kjo Gjykatë gjen se nuk qëndrojnë, sepse aktgjykimi është i bazuar në një mori provash të cilat janë administruar në gjykatën e shkallës së parë dhe atë në deklaratat e dëshmitarëve: B.Xh., E.Z., S.A., M.H., R.Z., ndërsa me pëlqimin e palëve në seancën e datës 17.9.2014, janë lexuar edhe deklaratat e dëshmitarëve: H.A., V.M., E.U. dhe të mjekëve - ekspert ligjor, dr. Sami Rexhepi, psikiatër dhe dr. Arsim Gërzhaliu, si dhe një numër i madh i provave materiale, kështu që nuk qëndron as pretendimi se deklaratat e dëshmitarit H.A. janë lexuar përkundër mospëlqimit nga ana e mbrojtësit të të dënuarit. Deklarata e dëshmitarit A. K. dhënë në polici dhe ajo dhënë në shqyrtimin gjyqësor është identike dhe nuk ka ndryshim, gjë që u vërtetua nga shikimi në shkresat e çështjes, që e bënë këtë pretendim të paqëndrueshëm.

Gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye se pse i ka besuar dëshmitarëve A.K. dhe H.A., të cilët në fakt kanë qenë dëshmitarët e vetëm okularë dhe të cilët deklarojnë se natën kritike me 11.3.2013 kanë pa tani të ndjerin F.M. së bashku me vëllain e tij E., duke iu afruar personave – F. dhe B., pasi që më parë i ndjeri F. ishte në automjet “Pezho” së bashku me dëshmitarin A. K. në rrugën e “Kovaçëve” dhe se para tyre ka qarkulluar një automjet “Golf” i cili e ka tejkaluar “Pezhon” dhe është ndalë. Në ndërkohë nga automjeti “Golf” ka dalë vozitësi duke i ngritur duart lartë dhe duke i fyer me fjalë ofenduese. Në ato momente nga automjeti “Pezho” ka dalë , tani i ndjeri F. dhe e ka goditur me shuplakë në fytyrë vozitësin e veturës “Golf” dhe ka filluar të përleshet me të dhe dëshmitari A., dhe personi tjetër i cili ka qenë në automjetin “Golf” i ka ndarë dhe janë nisur secili në rrugë të vet. I ndjeri F., e ka thirre në telefon vëllain e tij - të dënuarin E.M. duke i thënë “merre atë dhe bima” dhe pas disa minutash E., ia ka sjellë sendin e kërkuar që më vonë u konstatua se ishte thika. Janë kthyer tek vendi i ngjarjes dhe që të dy së bashku iu kanë afruar personave të cilët kanë qenë afër dyqanit dhe që të dy dëshmitarët A. K. dhe H.A., nga anët e ndryshme, kanë parë kur ka filluar përleshja në mes të tani të ndjerit F. dhe të dënuarit E., nga njëra anë dhe të dënuarve F. dhe B.K. sepse i ndjeri F. ka kërkuar numrin e telefonit të vozitësit të veturës “Golf”. Në ato momente të dy kanë vërejt se i ndjeri F. e ka goditur me diçka të dënuarin F.1 dhe se pas kësaj ka hyrë në automjetin e tij “Pezho” përderisa i dënuari F.1., ka shkuar tek vetura e tij, ka marrë diçka dhe i është afruar automjetit “Pezho” ku ka qenë i ulur F. dhe të njëjtin e ka goditur disa herë. Nga plagët e marra i ndjeri F. ka ndërruar jetë më vonë në Qendrën emergjente të QKUK, ndërsa nga raporti mjeko –ligjor si shkak i vdekjes janë konstatuar lëndimet e shkaktuar me një mjet i cili posedon maje dhe teh. Po ashtu, dëshmitari A., deklaron se ka parë se i dënuari E. ka qenë i ulur në karrigen e pasme dhe se njëri prej të dënuarve e ka sulmuar dhe atë. Të gjitha këto janë fakte të cilat janë konstatuar nga deklaratat e dy dëshmitarëve si dhe nga provat materiale të administruara në shqyrtim gjyqësor.

Gjykata e shkallës së dytë gjen se në këtë gjendje të vërtetuar faktike, gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar ligjin penal, kur të dënuarin F.K. e shpallë fajtor për veprën penale vrasje të kryer në tejkalim të mbrojtjes së nevojshme, gabim këtë të cilin gjykata e shkallës së dytë e përmirëson duke gjetur se kemi të bëjmë me veprën penale të vrasjes nga neni 178 të KPK-së e të cilat arsye i aprovon edhe kjo gjykatë dhe i konsideron si të drejta dhe të ligjshme.

Sa i përket pretendimit se në aktgjykimin e shkallës së dytë nuk janë dhënë arsye lidhur me vendimin mbi dënimin, respektivisht mungojnë arsyet për vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese e sidomos për faktin se në shkresat e çështjes ekziston një raport për gjendjen e shëndetit mendor të F.K., nga i cili raport rrjedh se në momentin e kryerjes së veprës penale ka qenë në gjendje të tronditjes së fortë mendore dhe se kjo ka bërë që gjykata e shkallës së dytë të bëjë gabimisht ricalësimin e veprës penale në dëm të dënuarit F.K., kjo Gjykatë gjen se ky pretendim nuk qëndron sepse nga shkresat e çështjes rrjedh se edhe vet të dënuarit F.dhe B.K. kanë kontribuar në krijimin e situatës në të cilën janë gjete me faktin se gjatë kacafytjes me të ndjerin F. dhe të dënuarin E., i dënuari F1. e goditë me shuplakë të dënuarin E. dhe me këtë rast e nxitë edhe më tepër situatën e tensionuar në mes të dy palëve të cilët kanë qenë akterë të ngjarjes në ditën kritike. Po ashtu, nga shkresat e çështjes rrjedh se ekspertiza psikiatrike sipas së cilës i dënuari F1. është vërtetuar se ka qenë në gjendje të tronditjes së rëndë mendore në momentin e kryerjes së veprës së penale, është vlerësuar gjatë matjes së dënimit nga gjykata e shkallës së parë, ndërsa gjykata e shkallës së dytë me rastin e shqiptimit të dënimit i ka marrë parasysh si të vërtetuara rrethanat me të cilat është udhëhequr gjykata e shkallës së parë me rastin e shqiptimit të dënimeve e sidomos ndaj të dënuarit F.K..

Sa i përket pretendimeve të mbrojtësit të të dënuarit B.K., kjo Gjykatë gjen se dispozitivet e aktgjytimeve të kundërshtuara janë të qarta, në arsyetim janë të dhëna arsyet për faktet vendimtare për të cilat ekzistojnë kontradiktat e konsiderueshme dhe se qarta përshkruhen veprimet e të dënuarit të cilat janë vërtetuar nga provat e administruara. Në aktgjykimin e shkallës së dytë po ashtu janë dhënë arsye për mos aprovimin e ankesës së mbrojtësit të të dënuarit e të cilat si të drejta i pranon edhe kjo gjykatë. Nga shkresat e çështjes rrjedhë se i dënuari Besnik aktivisht ka marrë pjesë në rrahjen e shkaktuar natën kritike me të cilin rast edhe ka ardhur deri tek vdekja e tani të ndjerit F.M. dhe se rrahjen nuk mund ta marrim si një ngjarje të izoluar nga fakti se rrahja dhe pastaj vrasja janë pjesë e një ngjarje e cila ka ndodhur si një tërësi, andaj edhe në aktgjytime janë trajtuar si një dhe arsye të dhëna kanë të bëjnë me të njëjtit dëshmitarë dhe prova të cilat janë shqyrtuar dhe për të cilat janë dhënë arsye.

Duke u nisur nga të gjitha këto që u thanë më lartë e meqenëse në dëm të të dënuarve nuk është shkelë ligji penal, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e konform nenit 437 të KPPK-së.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË
PML.nr.53/2017, më datë 27.2.2018

Procesmbajtës,
Bujar Balaj

Kryetare e kolegjit,
Emine Mustafa